



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 736 Prot.

Tiranë, më datë 21.06.2022

VENDIM  
Nr.240, datë 21.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.06.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik nga individ i licencuar në arkeologji Iris Pojani për projektin “Kompleks banimi me vila individuale 1 dhe 2 kate me 1 kat nëntokë, me pishinë dhe mur rrethues, Picallë” me aplikues Sokol Imeraj dhe zhvillues Afërdita Vorpsi;
2. Gjate procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr.27, datë 17.05.2018, “Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nga DRTK Tiranë;
3. Gjatë procesit të zbatimi, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr.27, date 17.05.2018, “Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” , nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

